



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.347/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Esat Ejupi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 27.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.347/2025, datë 24.10.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, Esat Ejupi nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, Esat Ejupi, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me të cilën pretendon se është evidentuar një parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në QKN Podujevë. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se gjatë përfundimit të procesit numërimit në QKN, është konstatuar një numër i konsiderueshëm i votave nuk figurojnë në vendvotimet përkatëse. Sipas ankuesit, këto vendvotime lidhen kryesisht me votues që i takojnë raporteve familjare e po ashtu edhe konstatime të vëzhguesve nga vendvotimet kanë pohuar se kanë vërejtur numër më të madh të votave për të gjatë numërimit të fletëvotimeve për kuvendin komunal në Podujevë. Vendvotimet që sipas tij ka hasur dyshime janë: vendvotimi 1807 shkolla "Ibrahim Rugova", 1812 Bradash, 1817 Gllamnik , 1818 Shajkofc , 1829 Sekiraçë, 1823 Orllan, 1821 Batllavë, 1827 Obranqë, 1835 Sibovc i Epërm, 1838 Buricë, 1815 Llapashticë e Epërme, 1842 Llapashticë e Poshtme dhe 1826 Dumnicë e Epërme. Parashtruesi i ankesës pretendon se këto vota i janë pohuar nga familjarë dhe numër i konsiderueshëm i tyre edhe verifikuar natën e zgjedhjeve nga ekipet përkatëse në vendvotime dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga KQZ, gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e tyre e pashpjegueshme e kjo gjendje ngre dyshime të bazuara se ka pasur mos regjistrim, humbje, tjetërsim ose trajtim të pasaktë të këtyre fletëvotimeve, çka përben shkelje të drejtpërdrejt të ligjit dhe parimeve themelore të procesit zgjedhor i cili sipas LZP-së, çdo qytetar me të drejtë votë duhet të ketë mundësinë që vota e tij të pranohet, të numërohet dhe të reflektohet në rezultatin përfundimtar. Mosregjistrimi ose

zhdukja e disa votave bie ndesh me: Nenin 4 të Ligjit, i cili garanton barazinë e votës dhe respektimin e vullnetit të qytetarëve dhe Standartet Ndërkombëtare për zgjedhjet e lira dhe të ndershme, të sanksionuara edhe nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut.

Andaj, bazuar në këto rrethana parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP, të urdhërojë verifikimin e plotë të procesit të pranimi, ruajtjes dhe numërimit të votave nga qendrat e votimit për Komunën e Podujevës, më qëllim të identifikimit të shkaqeve të mos pasqyrimin të një numri të konsiderueshëm të votave, në vendvotimet e lartcekura, të kërkojë sqarim zyrtar nga KQZ mbi trajtimin e këtyre fletëvotimeve dhe të bëjë rinumërimin e tyre, të ndërmerren masat e nevojshme ligjore për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, duke përfshirë rihapjen dhe rivlerësimin e kutive përkatëse, nëse është e nevojshme dhe ankesa të pranohet si e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallën nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse aktiviteti i QKN-së në Podujevë është përmbyllur me datën 17.10.2025 ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 24.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, par.1 të LZP. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes se supozuar. Në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, gjatë shqyrtimit të ankesës pala nuk ka bashkangjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parshtrësia, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjet në ankesë të KQZ-së, vlerëson se, parashtrësi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 24.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigje nga KQZ dhe provave të bashkangjitura Paneli vlerëson se, procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 17.10.2025.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, parashihet që: *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo kuptohet se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që: *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara",* ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që *"Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR".*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

PZAP vlerëson se, nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Podujevës, është përmbyllur më datë 17.10.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve, ndërsa ankuesi lidhur me pretendimet se ka pasur parregullsi në numërim të votave ka paraqitur ankesën me datë 24.10.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Andaj meqenëse ankesa e ankuesit është paraqitur jashtë afatit ligjor, Paneli ka vendosur që ankesa e ankuesit të hedhet si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.347/2025, datë 27.10.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.